

AKT THEMELIMI

PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “ FOOD CONCEPT ” SH.P.K

Sot më datë 19.06.2023 unë shtetasi :

Z.LORVAL PETANI I biri I **ANESTI**-it dhe **LULJETA**-s, i datëlindjes 13.06.1977, shtetas Shqipëtar lindur e banues ne **DURRES**, me ID. H70905142B, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar .

Vendosa të themeloj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “ **Food Concept** ” SH.P.K si më poshtë vijon:

Neni 1

Personi fizik i sipërpërmendur, me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë në pajtim me legjislacionin shqiptar, krijoi shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K) me emertimin “**Food Concept**” SH.P.K

Ortak i vetëm i kësaj shoqërie është Z. Lorval Petani .

Administrator i kësaj shoqërie do të jetë Z. Lorval Petani.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saj brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të çmohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

Neni 2

Shoqëria “**Food Concept**” SH.P.K, gëzon statusin e personit juridik. Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi. **Qendra e saj ndodhet në adresën: Lagjja Nr. 13, Plazh, Rruga “Pavarësia”, Godinë banimi dhe shërbimi 10 kat mbi tokë dhe 1 kat “Garazhd”, kt.1 , Durrës.**

Statuti i shoqërisë i bashkëngjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e saj.

Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtjen : “**Food Concept**” SH.P.K

Neni 3

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë të pacaktuar

Neni 4

Shoqëria “Food Concept” SH.P.K do të ketë si objekt veprimtarie si më poshtë :

Import - Eksport , aktivitet tregtar në fushën e hotelerisë dhe turizmit. Bar Restorant Pasticëri, si dhe çdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për vijimin e aktivitetit të shoqërisë .

Neni 5

Kapitali themeltar i kësaj shoqërie është **1.000.000 (Një milion) Lekë.**

Neni 6

Fitimi neto që do të realizohet nga veprimtaria e kësaj shoqërie i përket në masën **1 kuotë - 100% ortakut Z. Lorval Petani .**

Neni 7

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie, kjo shoqëri përgjigjet vetem me kapitalin e saj. Ortakët e saj nuk mbajnë përgjegjësi për detyrimet e shoqërisë me pasurinë e tij që nuk bën pjesë në kapitalin e kësaj shoqërie.

Neni 8

Marrëdhëniet e punës në shoqëri ose në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

Neni 9

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj.

Parashikimet e mësipërme të aktit të themelimit pasi u lexuan me vëmendje dhe u gjetën konform vullnetit të tij e firmos nga Themeluesi i shoqërisë pa vërejtje.

ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË

LORVAL PETANI

